



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:232381
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05469327

AC.nr.793/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh. Th., nga fshati B., Komuna e Klinës, të cilin me autorizim e përfaqëson T... R., avokat me seli në Pejë, Rruga “Sh. B.”, pn, kundër të paditurës Komuna e Klinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë si dhe shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, C.nr.700/21, të datës 06.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Klinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, C.nr.700/21, të datës 06.01.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.700/21, të datës 06.01.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon: APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. Th., nga fshati B., Komuna e Klinës. DETYROHET e paditura Komuna e Klinës, Drejtoria e Arsimit, që paditësit t’ia paguajë në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës, shumën prej 350.00 euro, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 deri me datë 02.07.2021, apo gjithsejtë për 175 ditë pune, si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 497 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 02.07.2021, apo gjithsejtë për 710 ditë pune, shuma e përgjithshme në lartësi prej 847 euro, me kamatë ligjore, në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 18.10.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë, në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure, në shumë prej 124.00 euro (njëqind e njëzet e katër), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja-pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbartimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e të paditurës të aprovohet si e bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar apo i njëjti të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se paditësi të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1, pika c) dhe d) dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se, paditësi me datë 18.10.2021, pranë gjykatës kompetentë të shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë si dhe shpenzimeve të udhëtimit, përmes së cilës ka pretenduar se i njëjti është punëtor i arsimit i punësuar në SHMU “A. B.” në G. dhe se udhëton nga fshati B. për në fshatin K.. dhe anasjelltas ashtu që ka kërkuar që të detyrohet e paditura që për ditët e pranisë së tij në punë në emër të kompensimit për ushqim t’ia kompensojë shumën prej 350,00 € derisa për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 497,00 € e këtë ta bëjë në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar (*pa shqyrtim kryesor të çështjes*) C.nr.700/21, të datës 06.01.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura. Gjykata përmes vërtetimit të lëshuar nga e paditura mbi ditët e prezencës në punë të paditësit lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe të udhëtimit vërtetoi faktin se sipas vërtetimit me Nr. prot. 243/21, i datës 06.07.2021, paditësi nga data 14.09.2020 e gjerë me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 175 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa nga data 18.04.2017, dita kur kontrata kolektive ka hyrë në fuqi e deri me datë 02.07.2021, paditësi ka realizuar gjithsejtë 710 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim, kurse me vërtetimin e lëshuar nga Agjencia e udhëtimit “Qlirimi Tours” me 06.07.2021, vërtetohet se paditësi udhëton për çdo ditë të punës nga fshati B. për në fshatin K. dhe anasjelltas. Po ashtu ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se paditësi nuk i ka realizuar kërkesat e tij për kompensimin e shujtave dhe kompensimin e udhëtimit gjë që vërtetohet edhe nga përgjigja në padi e të paditurës.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35, paragrafi 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2017 e lidhur me nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Lidhur shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452, paragrafi 1 të LPK-së. Po ashtu për vendosjen jashtë seancës gjyqësore, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 398 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka vendosur si në dispozitiv të saj lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, pasi që nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar tek e paditura, përkatësisht në shkollën e mesme të ulët "A.B." në G. dhe kjo vërtetohet përmes Kontratës së Punës me nr.112-846/16, të datës 01.09.2015 si dhe nuk janë kontestuese ditët e pranisë së tij në punë dhe kjo vërtetohet nga Vërtetimit me nr. protokolli 243/21, të datës 06.07.2021, të lëshuar nga vet e paditura të bashkangjitur si në shkresa të lëndës nga i cili provohet se paditësi për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar ka qenë në vendin e punës, përkatësisht për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri më datë 19.04.2021 për gjithsej 175 ditë pune.

Prandaj pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale nuk qëndrojnë për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve". Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*". Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës". Me paragrafin 5 përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*". Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: "*Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy €) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim*". Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: "MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023".

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitivi të aktgjykimit të ankimuar me të drejtë është bazuar në nenin 35, paragrafi 7 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ku në këtë nen ndër të tjera thuhet se: “...*“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*”.

Lidhur me shumën e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35, paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: “...*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”, e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, ndërsa paditësi deri në momentin e plotësimit të kushtit i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me këtë kontratë lidhur me kompensimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e tij është e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar vërtetohet në tërësi. Në këtë kontekst, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur prova dhe se nuk janë konfirmuar relacionet e udhëtimit e as vlera e biletës së udhëtimit për të vendosur lidhur me shpenzimet e udhëtimit, ngase nga provat e administruara gjegjësisht nga vërtetimi i bashkangjitur në shkresë të lëndës, i datës 06.07.2021 lëshuar nga Agjencia e Udhëtimit “Qlirim Jusufi” vërtetohet se paditësi udhëton çdo ditë pune, pra pesë ditë në javë me agjencionin e tyre në relacionin B. për në fshatin K. dhe anasjelltas dhe çmimi i biletës për një drejtim është 0,50 € si dhe nga certifikata e vendbanimit me nr. B 10332913 nga e cila vërtetohet se paditësi ka adresën e tanishme të banimit në fshatin B., Klinë, ashtu që paditësit ka paraqitur prova konkrete të elaboruara si më lartë mbi të cilat prova e ka mbështetur edhe kërkesën e tij për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën për arsye se e njëjta nuk është nënshkruese e saj, mirëpo këto pretendime Gjykata e Apelit i vlerëson si të paqëndrueshme pasi që referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Klinës, Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 ndër të tjera thuhet se: “*Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...*”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'i paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në përputhje me dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, e i nën cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.793/2023, më datë 18.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj